



“Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 258-25 të Kodit Penal”.

2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjykimit të shkurtuar. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Flora Hajredinaj, Erjon Çela dhe Irena Gjoka, me vendimin Nr. 6, datë 15.01.2025 vendosi:

1.

- Deklarimin fajtor të të pandehurës Rajmonda Balilaj, për veprën penale “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 258 (para ndryshimeve të pësuara me ligjin nr. 43/2021, datë 23.3.2021) dhe 25 të Kodit Penal, dhe dënimin e saj me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.
- Në bashkim të dënimeve, sipas nenit 55 paragrafi 1 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurës Rajmonda Balilaj me një dënim të vetëm prej 2 (dy) vjetësh burgim.
- Në bazë të nenit 406 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurës Rajmonda Balilaj, i ulet 1/3 e dënimit, për shkak të aplikimit të gjykimit të shkurtuar dhe, përfundimisht dënohet me 1 (një) vit e 4 (katër) muaj burgim.
- Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurën Rajmonda Balilaj, dhe vënien e saj në provë për një periudhë prej 2 (dy) vjet e 8 (tetë) muaj, me kusht që e pandehura gjatë periudhës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e saj. Afati i provës fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit për pezullimin e dënimit me burgim.

- Heqjen e së drejtës për të pandehurën Rajmonda Balilaj për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 (pesë) vjet, bazuar në nenin 35 paragrafi 2, të Kodit Penal.
2. Deklarimin fajtor të të pandehurës Anisa Petani, për veprën penale “*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*”, në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 258 (para ndryshimeve të pësuara me ligjin nr. 43/2021, datë 23.3.2021) dhe 25 të Kodit Penal dhe dënimin e saj 1 (një) vit burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurës Anisa Petani, për veprën penale “*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*”, në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 258 (para ndryshimeve të pësuara me ligjin nr. 43/2021, datë 23.3.2021) dhe 25 të Kodit Penal dhe dënimin e saj me 1 (një) vit burgim.
  - Në bashkim të dënimeve, sipas nenit 55 paragrafi 1 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurës Anisa Petani, me një dënim të vetëm 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.
  - Në bazë të nenit 406 pika 1 të Kodit të Proçedurës Penale, të pandehurës Anisa Petani, i ulet 1/3 e dënimit, për shkak të aplikimit të gjykimit të shkurtuar dhe, përfundimisht dënohet me 1 (një) vit burgim.
  - Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurën Anisa Petani, dhe vënien e saj në provë për një periudhë prej 2 (dy) vjet, me kusht që e pandehura gjatë periudhës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e saj. Afati i provës fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit për pezullimin e dënimit me burgim.
  - Heqjen e së drejtës së të pandehurës Anisa Petani për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 (pesë) vjet, bazuar në nenin 35 paragrafi 2, të Kodit Penal.
3. Deklarimin fajtor të të pandehurës Enirjada Rizaj, për veprën penale “*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*”, në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 258 (para ndryshimeve të pësuara me ligjin nr. 43/2021, datë 23.3.2021) dhe 25 të Kodit Penal dhe dënimin e saj 1 (një) vit burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurës Enirjada Rizaj, për veprën penale “*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*”, në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 258, (para ndryshimeve të pësuara me ligjin nr.43/2021, datë 23.3.2021) dhe 25 të Kodit Penal dhe dënimin e saj me 1 (një) vit burgim.
  - Në bashkim të dënimeve, sipas nenit 55 paragrafi 1 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurës Enirjada Rizaj, me një dënim të vetëm 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.
  - Në bazë të nenit 406 pika 1 të Kodit të Proçedurës Penale, të pandehurës Enirjada Rizaj, i ulet 1/3 e dënimit, për shkak të aplikimit të gjykimit të shkurtuar dhe, përfundimisht dënohet me 1 (një) vit burgim.
  - Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurën Enirjada Rizaj, dhe vënien e saj në provë për një

- periudhë prej 2 (dy) vjet, me kusht që e pandehura gjatë periudhës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e saj. Afati i provës fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit për pezullimin e dënimit me burgim.
- Heqjen e së drejtës së të pandehurës Enirjada Rizaj për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 (pesë) vjet, bazuar në nenin 35 paragrafi 2, të Kodit Penal.
4. Deklarimin fajtor të të pandehurit Shkëlqim Beqiraj, për veprën penale “*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*”, në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 258 (para ndryshimeve të pësuara me ligjin nr. 43/2021, datë 23.3.2021) dhe 25 të Kodit Penal, dhe dënimin e tij 1 (një) vit burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit Shkëlqim Beqiraj, për veprën penale “*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*”, në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 258 (para ndryshimeve të pësuara me ligjin nr. 43/2021, datë 23.3.2021) dhe 25 të Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim.
  - Në bashkim të dënimeve, sipas nenit 55 paragrafi 1 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit Shkëlqim Beqiraj, me një dënim të vetëm 1(një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.
  - Në bazë të nenit 406 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit Shkëlqim Beqiraj, i ulet 1/3 e dënimit, për shkak të aplikimit të gjyqimit të shkurtuar dhe, përfundimisht dënohet me 1 (një) vit burgim.
  - Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurin Shkëlqim Beqiraj, dhe vënien e tij në provë për një periudhë prej 2 (dy) vjet, me kusht që i pandehuri gjatë periudhës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e tij. Afati i provës fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit për pezullimin e dënimit me burgim.
  - Heqjen e së drejtës së të pandehurit Shkëlqim Beqiraj për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 (pesë) vjet, bazuar në nenin 35 paragrafi 2, të Kodit Penal.
5. Shpenzimet proceduriale, ato të kryera gjatë fazës së hetimit paraprak u ngarkohen të pandehurve të këtij gjykimi solidarisht me bashkëpandehurit e tjerë të të njëjtit procedim penal, dhe ato të kryera gjatë shqyrtimit gjyqësor, sipas procesverbalit bashkëngjitur këtij vendimi, u ngarkohen të pandehurve të këtij gjykimi, në mënyrë solidare.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

Tiranë, më datë 15.01.2025

[shqiptarja.com]